



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 11, datë 11.03.2015

Për

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSITË PËR DISA FAMILJE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 29, pika 1 dhe nenin 55, pika 1, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 2 pika 4 dhe nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 për “Emergjencat civile” (i ndryshuar); të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.5.2012 për “Kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 30.12.2015, për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016” me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Ti akordojë një ndihmë financiare familjeve të cilave iu është dëmtuar banesa dhe orënditë shtëpiake nga zjarri si më poshtë:
 - a. Për familjen e z. **Isa Toska 542.548** (pesëqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e dyzet e tetë lekë) lekë;
 - b. Për familjen e z. **Festim Dalipi 238.561** (dyqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë ;
 - c. Për familjen e z. **Mustafa Sami Jahja 1.483.931** (një milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë;
 - d. Për familjen e z. **Fiqiri Qazim Reçi 999.436** (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë;
 - e. Për familjen e z. **Riza Qazim Reçi 1.446.403** (një milion e katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e katërqind e tre) lekë.

2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2016.

3. Për zbatimin e këtijë vendimi ngarkohet, Drejtoria e Financë Administratës, Drejtoria e Strehimit dhe Monitorimit Bashkisë së Tiranës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI